



P R O C E S V E R B A L

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më **08.09.2021**, me fillim në ora **10.00**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

Kryesuesi – Fillimi më lejoni të përvendos, nënkyetarin **Fatmir Iska**, te nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtoret e drejtive, përfaqësues të mediave dhe të gjithë ju të pranishëm.

Të nderuar anëtarë të KPF-së, për këtë mbledhje propozoj këtë :

R E N D D I T E

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i Propozim vendimit për miratimin e Buxhetit për vitin 2022;**
- 3. Shqyrtimi i Propozim vendimit për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021;**
- 4. Informatë nga DKA-ja për përgatitjen e fillimit të vitit të ri shkollor 2021-2022;**
- 5. Informatë nga DSHPS-ja rreth situatës me Covid-19 ne Komunën e Rahovecit;**
- 6. Të ndryshme.**

Të nderuar kolegë, a jeni për këtë rend dite. Konstatoj se unanimisht aprovohet rendi i ditës. Kalojmë ne pikën e parë te rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

A ka dikush diçka sa i përket procesverbalit, nëse jo e qesim në votim. Atëherë konstatoj se unanimisht aprovohet procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Kalojmë ne pikën e dytë te rendit te ditës:

2. Shqyrtimi i Propozim vendimit për miratimin e buxhetit për vitin 2022.

Afrim Limani – Përvendetje për ju kryesues, anëtarë te KPF-së dhe gjithë te pranishmit në sallë. Në adresë te komunës tonë ka ardhur qarkorja e dytë buxhetore që ju nuk keni informata përpos momentit kur e keni votuar qarkoren e parë sipas ligjit te buxhetit, kështu që ju informoj se edhe qarkorja e dytë buxhetore është po e njëjtë me qarkoren e parë buxhetore mirëpo ka disa ndryshime te vogla brenda ne strukturë por pothuajse është e njëjtë me qarkoren e parë. Buxheti i komunës se Rahovecit për vitin 2022 si dhe projekcionet 2023-2024, pra për vitin 2022 buxheti i komunës se Rahovecit është 15,053,660 euro, ku grandi i përgjithshëm është 13,703,112 euro kurse te hyrat vatanake janë prej 1,350,548 euro, ku vetëm granti i përgjithshëm është 5,761,029 euro, grandi për shëndetësi është po i njëjti ne raport me vitin e kaluar prej 1,951,048 euro, pastaj grandi për arsim prej 5,965,882 dhe këshilli i Hoçës së Madhe prej 25,153 euro. Pra ne total kemi një buxhet prej 15,053,660 euro. Ndryshimi i buxhetit te vitit 2022 ne raport me vitin 2021 është me një ndryshim total prej 837,000 euro dhe te ky buxhet ndryshimi është grandi 597,900 euro si dhe rritura e

të hyrave vetanake për këtë vite i kemi 289,455 euro dhe kjo rritje është e buxhetuar në investime kapitale me përjashtim te një përqindje te vogël që ka shkuar ne pozicionin e pagave sepse llogaritja te stazhi i punës që përfshin prej 0,5% dhe pjesa tjetër është ne investime kapitale. Ky buxhete është i shpérndarë, ku ne kuadër te pagave dhe mëditjeve kemi 7,872,844 euro, pastaj ne mallra dhe shërbime 1,735,000, pastaj ne shpenzime komunale 270,000, subvencione dhe transfere 360,000 dhe investime kapitale prej 4,815,816 euro. Për këtë mbledhje te KPF-së nuk e kam përgatit pjesën për me prezantuar ne monitor dhe këtë e kam lanë për ne mbledhjen e kuvendit që aty do ta shohim me se miri. Ju para vetes e keni dokumentin e po ashtu edhe listën e projekteve kapitale që paraprakisht mund te ju them se kjo liste e projekteve kapitale është përgatitur kryesisht ne bazë te kërkessave te cilat kanë dal nga debatet që kemi pasur me qytetare ju anëtare te KPF-së dhe gjithashtu ka pasur kërkësë te njëjtë kanë qene edhe debatet që i ka mbajtur kryetari me qytetare, Pra te gjitha kërkessat e qytetareve janë te përfshira ne listën e projekteve kapitale edhe pse nga lista e projekteve kapitale mundet me u krijua ndonjë huti ne përmbajtje që ndoshta edhe nuk mundet me qenë ashtu mirëpo secili drejtor e ka edhe emërtimet e projekteve kapitale te cilat do te investohen p.sh. po supozojmë te ndërtimi i rrugëve fushore ku për shkak te programit te sistemit Pip nuk kemi mundur me u zgjerua ne tekst mirëpo secili drejtor i ka shënimet e veta që me ju dhanë informata shtesë lidhur me investimet që do te bëhen. Mirëpo ajo ka është karakteristike dhe që vlen te përmendët për ju është se vitin e kaluar ka dalë një udhëzim i ri administrativ i cili ju nënshtrohet disa kritereve para se me i futë te dhënat ne sistemin Pip(Programi informativ i projekteve), pasi për me i ikë rrezikut nga kjo jemi detyruar që edhe brenda këtij viti te lidhim disa kontrata që korrespondojnë drejtpërdrejt me kontrata që janë me vlera te mëdha e sidomos te ndërtimi i rrugëve, ndërtimi i kanaleve, pastrimi i lumenjve dhe shumë projekte të tjera që korrespondojnë drejtpërdrejt në kuadër të këtyre projekteve që i kemi ne listën e projekteve kapitale.

Kryesuesi – Faleminderit shumë drejtor për sjelljen e buxhetit, siç e thatë edhe vetë që janë të përfshira të gjitha kërkessat e qytetarëve gjatë takimeve që kemi pasur Komiteti për Politikë dhe Financa nëpër të gjitha vendbanimet dhe të gjitha kërkessat janë të përfshira.

Dervish Çadraku – Përshëndetje kryesues, drejtorë, kolegë dhe gjithë ju të pranishëm. Unë në fakt nuk jam shumë i njoftuar me përmbajtjen e materialit e sidomos të investimeve kapitale konkretisht, por, mua më intereson se është një praktikë e vjetër se investimet kapitale nuk po i qesin në emra të përvëcëm përgjithmonë ne mënyrë të përgjithësuar me plot investime. Dhe tash po lind pyetja se disa projekte në të kaluarën ose nuk kanë filluar hiq ose janë në gjysmë dhe kanë mbetur ashtu pasi ju shpesh kaloni përskaj atyre projekteve dhe I shihni. Kështu që ato projekte a kanë mbetur për shkak te mungesës se buxhetit apo për shkak se ende nuk ka arrit punë kryesi me i realizua, sepse shpesh herë praktikohet se tani nuk i kemi paret por më pastaj i fusim në buxhet tjeta në të ardhmen kështu që i kompensojmë punë kryesit të cilët vet i fusin aty si p.sh. kemi oborre të shkollave, trotuare, rrugë fushore të cilat janë folur disa herë në këtë sallë të Kuvendit mirëpo ato punë nuk janë kryer dhe kjo a është mungesë e mjeteve apo ato punë punë kryesi nuk ka arritur me i realizua.

Afrim Limani – Ashtu siç e thash cdhc me pare, për shkak te këtij programi sistemi Pip, ne jemi detyruar shkurtimisht me emërtua një projekt por secili drejtor I ka informatat shtesë për përmbajtjen e atij projekti, p.sh. rrugët fushore, kështu që drejtori i ka te gjitha shënimet se ku ka me u investua ne cilin vendbanim edhe cilat rruge kanë me u projektua edhe me u ekzekutua. Siç e thashë dhe ne fillim se ka dal ai udhëzim administrativ vitin e kaluar dhe siç jeni ne dijeni disa projekte tona kanë kaluar ne rezerva pasi ministria e financave na ka mundësua dhe jo me na i heqë përfundimisht, pasi janë afér 9 projekte por fatbardhësisht me vlera te vogla që nuk kanë kaluar dhe i kanë lanë ne rezerva. Ne e kemi mbajtur mbledhjen e kuvendit dhe bashke me vendimin e juaj ato mjete i kemi kaluar ne kuadër te disa projekte te tjera ekzistuese që kanë qenë sepse ne nuk e kemi pasur këtë problem me ju nënshtrua kritereve dhe për këtë arsyе ne tash këto projekte i kemi emërtuar kështu. Po ashtu edhe për pyetjen tjetër, unë në cilësinë e drejtorit për buxhet dhe financa e di se te gjitha projektet kanë filluar dhe për këto projekte ka buxhet ndoshta jo mjaftueshëm por ka buxhet me fillua punimet edhe me u ekzekutua ato ndërsa pjesa tjetër janë të buxhetuara për vitin 2020. Kështu që konkretisht nëse keni pyetje për ndonjë projekt të caktuar mundesh me adresua atë pyetje. Po ashtu desha me ndërlidh pasi të ju vazhdimisht krijohet huti ndonjëherë pasi shume projekte figurojnë vazhdim sepse jemi detyruar me shkua këtë formë që mos me ju nënshtrua atyre kritereve apo udhëzimi që me rrezikua që mos

me na kaluar projektet. Tash këtë vite nuk kalojnë në rezerva por automatikisht bie ai projekt dhe ne kuadër te asaj vlere që kemi buxhetuar edhe ato para shkojnë huqe p.sh. nga raporti i kontratave nga Zyra e Prokurimit edhe me kuptua çka është kjo p.sh. në kuadër të drejtorisë së bujqësisë një kontratë që është lidhur, që në kuadër të kontratës rregullimi i kanalit për kullimin e tokave bujqësore që është si emërtim apo projekt.

Dervish Cadraku – Konkretisht unë ato i kuptova dhe janë te njohura për neve sepse ajo është mirë që është ndarë në loto sepse edhe janë hapësira të mëdha dhe sigurisht që janë arsyet tjerë, por konkretisht oborri i shkollës se Malësisë se Vogël si qëndron puna aty pasi asnjë punë sa do e vogël nuk është bërë aty dhe gjithashtu gjate rrugës Malësi e Vogël, Gexhë, Gradish ka pas me u ndërtua trotuari që realisht edhe aty nuk është bërë asgjë, tash po dua me ditë se ku është problemi sepse nuk pata mundësi me pa që mos i keni fut në projektet e reja pasi faktikisht nuk është punuar asgjë dhe kjo i bien që sikur mos me pas hiq projekt aty.

Kryesuesi – Atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës pasi përmomentin nuk është i pranishëm drejtori i Financave për prezantimin e pikës se tretë.

3. Informatë nga DKA-japër përgaditjen e fillimit te vitit te ri shkollor 2021-2022.

Avni Morina – Në fund të muajit gusht kemi bërë përgjedhjen e teksteve alternative të miratuara nga shtëpitë botuese nga ministria e arsimit ku nga nga aktivitet profesionale te shkollave kemi plotësuar katalogët e kërkuar nga ministria e arsimit dhe i kemi dërguar me kohë ne ministrinë e arsimit, gjithashtu ka filluar furnizimi me tekste shkollore te fazës se parë te katalogjeve që janë hartuar nga ministria e arsimit ndërsa faza e dytë siç duket do te vonohet për shkak se miratimi i tyre është bërë me vonesë. Me 28 gusht është mbajtur afati i dytë i provimit shtetëror te maturës ne dy qendra ne te cilën kanë marr pjesë 170 maturant dhe rezultatet i kemi marr para dy dite, ku rrëth 70% te atyre që kanë marrë pjesë ne testin përfshirë afatin e dytë kanë kaluar. Ndërkohë ka vazhduar edhe procesi i vaksinimit i te gjithë punëtoreve te arsimit dhe deri me datën 1 shtator nga shënimet e fundit që i kam nga të dhënat që i kam nga drejtoret e shkollave janë vaksinuar 710 punëtor t'arsimit apo shprehur ne përqindje 81.8% nga numri i përgjithshëm i tyre dhe shpresoj që këto ditë është rritur edhe me shume numri i te vaksinuarve dhe informatat po i marrim ne mënyrë te vazhdueshme. Më datën 30-31 gusht ne bashkëpunim me drejtorin e shëndetësisë dhe QKMF-në është bërë dezinfektimi deratizimi dhe dezisektimi i objekteve shkollore dhe për disa objekte që janë duke u riparuar atëherë do bëhet gjatë kësaj javë sepse nuk ka qenë e mundur te bëhet. Edhe pse DKA-ja ka kërkuar që nga muaji prill të këtij viti furnizimi me inventar te katër objekteve dhe tri çerdheve te reja te ndërtuara nga buxheti i Komunës tonë, ky furnizim akoma nuk ka ndodhur nga ministria e arsimit shkencës dhe teknologjisë dhe inovacionit. Kërkosat përinventar i kemi shoqëruar se bashku edhe me specifikacionet para masat përkatëse mirëpo furnizimi akoma nuk ka ndodhur. Unë kam kontaktuar edhe me departamentin e infrastrukturës ne ministrinë e arsimit dhe jemi ne kontakt me ata mirëpo per shkak te procedurave te prokurimit njëri prej operatoreve është ankuar ne AQF dhe lënda ka shkuar OSHP dhe siç duket para muajit tetor nuk do te vjen inventari dhe ne do te jemi te shtrënguar që ne Reti dhe Hoçë te vogël te fillojmë me inventar te vjetër dhe po shpresojmë që brenda këtij muaji te vjen edhe inventari për 3 çerdhet që pothuajsc janë te gatshme. Kështu që përfund urojmöre që numri i rasteve të infektuar dhe të vdekur nga pandemia te zvogëlohet ne minimum dhe te krijohen rrethana për një fillim sa me te mbarë. Informacioni i fundit që dje kemi pasur një takim online me ministrin e arsimit me te gjithë drejtorët e DKA-ve edhe pse te gjitha DKA-të janë shprehur te gatshme që te fillojmë me vitin e ri shkollor ashtu siç është planifikuar nga qeveria me datën 13 me prezencë ne shkolle mirpo te gjithë ishin të mendimit se kjo gjendje nuk do të varet nga ne sa do të varet nga pandemia Covid-19 dhe krejt varet nga rekomandimet që vinë Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik.

Dervish Çadraku – Faleminderit kryesues, për aq sa kam mundur me shikua sipërfaqësish informacionin atëherë po del që ju apo ne si shoqëri nuk kemi arritur ende me bo seleksionimin apo zgjedhjen e teksteve shkollore, pasi unë mendoj që nuk i ka ndalua askush ekipet e caktuara që me i krye këto pune me herët që viti shkollor me fillua me tekste shkollore, kështu që unë mendoj që furnizimi me libra do te jetë i vonuar përsëri pasi deri sa nuk kemi mundur me i përgjedh dhe tash po vonohemi mbi dy javë për shkak të virusit Covid-19 gjithashtu edhe librat që po vonohen, nuk e di si do të ja dalin kështu pasi këto punë kanë mundur të kryhen shumë më herët pasi virusi nuk ka mundur të ndikojë në përgjedhjen seleksionimin ndarjen pastaj krijimi i stoqeve neper shkolla, pra ju jeni ende të pa furnizuar me libra. Pastaj ju e thatë 80% te arsimtareve

janë të vaksinuar njëherë apo dy herë, mirëpo si do të silleni me ata që hezitojnë te kryejnë vaksinimin, a do te kenë te drejtë çasjeje në shkollë, pasi vërtet ne QKMF ka tollovi në qendrat e vaksinimit dhe pse nuk i keni ndarë atë 20% që me i dërgua ne mënyrë te organizuar që me krye vaksinimin ë mos me pas kësó probleme edhe ne këtë drejtim me shkolla.

Avni Morina – Për tekstet janë 6 shtëpi botuese që janë të licencuara dhe të akredituara nga MASHT-i për tekste shkollore për klasat 0-9. Faza e parë ka qenë qershori – korrik dhe atë fazë të përzgjedhjes së teksteve e kemi kryer me herët mirëpo kanë qenë klasat e 3-ta, 7-ta dhe të 8-ta për te cilat nuk ka pasur botime deri sivjet. Ministria e arsimit i ka licencuar këto me vonesë dhe deri me 18 gusht nuk na ka sjellë te secila shtëpi botuese te furnizojnë DKA-të me tekste shkollore. Pastaj me 18 gusht na kanë sjellë katalogun ne te cilën janë përshkruara te gjitha ato emrat e shtëpive botuese dhe titujt e librave që janë aprovue nga ministria dhe kemi pasur afat vetëm 5 ditë nga data 20-25 gusht me i përzgjedh tekstet shkollore nga shtëpitë botuese përmes aktivave profesionale te shkollave. Në çdo shkollë i kemi aktivët profesionale te shkollave dhe kemi qenë shume te angazhuar për shkak te vlugut te punëve te mëdha për me bo përzgjedhjen e tyre. Me datë 25 gusht e kemi dërguar katalogun e plotësuar nga DKA-ja përmes shënimeve që i kemi marr prej shkollave dhe i kemi përcjell ne ministrinë e arsimit. Sikur shtëpitë botuese ti kishin te gatshme te botuara ato tekste që ishin te aprovuara nga ministria e arsimit edhe sikur ta dinim se çfarë numri te teksteve do ti jep komunës se Rahovecit, furnizimi do te bëhej menjëherë pra e kam fjalën 3-të, 7-të dhe të 8-të, mirëpo ata ende nuk e kanë ditur para datës 25 gusht. Pra me një çfarë forme problemi ka shkuar zingjir pasi edhe ministria është vonuar deri sa e ka aprovuar shtëpinë botuese e me pastaj këta e kanë pritë i kanë marr kërkesat prej DKA-ve te komunave dhe tash pasojat po i vuajmë ne si komunë dhe ende nuk jemi te gatshëm për fillimin e vitit te ri shkollor sa i përket teksteve shkollore. Sa i përket vaksinimit, e dhashë shifrën deri me 1 shtator kanë qenë 81.8% te vaksinuar me dozën e par ndërsa me dozën e dytë është numër shume i vogël, këto ditë po besoj që është rritur numri i të vaksinuarve pasi i përcjellim shënimet dhe i përditësojmë ato shëнимet sepse kemi kërkesë edhe prej ministrisë se arsimit që po na kërkojnë shënimë çdo ditë me i përditësua, kështu që shpresojmë që deri me 13 shtator kur edhe pritet te fillon viti shkollor të kryhet vaksinimi i plotë i të gjithë mësimdhënësve por, sido që te jetë nëse ndonjë prej mësimdhënësve mbetet i pa vaksinuar pasi është edhe një numër i vogël i tyre që kanë mbet te pa vaksinuar atëherë është edhe një vendim prej ministrisë se shëndetësisë që asnjë punëtor qoftë i arsimit apo zyrtar publik nuk mund te jet ne vendin e punës pa e pasur te paktën dozën e parë te vaksinës. Unë edhe vet si drejtor i DKA-së e kam shfrytëzuar autoritetin tim e kam marr vaksinën edhe gjithashtu ju kam bo thirrje publikisht te gjithë mësimdhënësve që te vaksinohen. Ne nuk kemi nxjerr vendim dhe ndoshta edhe ministria e arsimit ska pasur te drejt te nxjerr vendim sipas ligjit mirëpo thirrje ju kemi bërë vazhdimisht edhe po ju bëjmë edhe vaksinimi po shkon shume mirë pasi këto dy javët e fundit kemi pasur vaksinim masiv edhe është duke vazhduar dhe shpresoj te kryhet kjo.

Dervish Çadraku - A keni mundësi ju me i thirr këta me një listë dhe me i dërgua hë mënyrë të veçantë arsimtarët edhe me i marr vaksinat drejtpërdrejt dhe me konsiderua si te kryer nga ana juaj.

Avni Morina – Ekziston platforma E-Kosova që sccili individualisht mund ta bëjnë terminin, në fillim ka pasur probleme sa i përket terminit për aplikim mirëpo tani gjendja është ne rregull dhe ashtu kemi pasur furnizime te reja me vaksina. Ne, listë të mësimdhënësve nuk mund te bëjmë pasi ajo ne një farë mënyre i bie sikur me i obligua dhe tash vendim për mënyrë obligative zyrtarisht nuk kemi dhe nuk guxojmë dhe gjithashtu edhe vetë ministri i arsimit nuk guxon me ju bo obligative deri më tash dhe vetëm atëherë kur Ministria e Shëndetësisë merr vendim atëherë ajo do te ishte e mirë se ardhur. Unë kam vullnetin që me ju bo thirrje vazhdimisht edhe me krye vaksinimin te gjithë mësimdhënësit dhe me fillua vitin shkollor sa me sigurt.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor për sqarimin, atëherë meqë nuk kemi tjerë te lajmëruar, kthehem ne pikën e tretë te rendit te ditës.

4. Shqyrtimi i Propozim vendimit për caktimin e normave tatimore për tatimin ne pronën e paluajtshme për vitin 2022.

Afrim Limani – Përshëndetje për ju anëtar te KPF-së. Sipas ligjit 06/L-05 kuvendi komunal është i obliguar që brenda çdo viti ti përcaktoj normat tatimore ne kuadër te tatimit ne pronë. Ju para vetes e keni një liste ku janë te specifikuara kategoritë e pronës dhe normat tatimore ë realisht normat tatimore nga viti i kaluar janë

po këto që i keni ne shënimet e juaja dhe sa për informimin tuaj mund te ju them se normat tatinore ne komunën tonë janë njerëz normat me te ulta ne nivel te Kosovës. Këto norma mundën me u rrit me vendimin e juaj me shkue deri ne 1%, që ne i kemi 0,16% dhe konsideroj që janë norma te arsyeshme duke vlerësuar edhe zhvillimin e ekonomik që e kemi si komunë por është detyre edhe përgjegjësi e juaja nëse vendosni me i rritë, pasi me poshtë nuk ka mundësi te shkojnë më.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor për prezantimin, atëherë meqë nuk kemi tjerë te lajmëruar, konstatoj se kalon për kuvend edhe pika e tretë e rendit te ditës. Kalojmë në pikën e pestë te rendit te ditës:

5. Informatë nga DSHPS-ja rrëth situatës se krijuar me Covid-19 në komunën e Rahovecit.

Samir Mustafa – Përvëndetje për te gjithë. Situata me Covid-19 është stabile dhe e menaxhueshme, deri ne këto momente kur po raportojmë nga fillimi i pandemisë kemi te paraqitura 2093 raste, ku raste te shëruara janë 1378 raste, me fatalitet kanë përfunduar 78 raste ndërsa aktive janë 637 raste. Po ashtu vazhdon vaksinimi masiv i popullatës kundër Covid-19 dhe deri ne këto momente kur po raportojmë janë dhënë 29,796 doza te vaksinave kundër Covid-19 që me dozën e parë janë vaksinuar 20,040 qytetare me 4242 Astra Zeneca 15,798 Pfizer ndërsa me dozën e dytë e kanë marrë 9756 qytetarë me 2063 me vaksinën Astra Zeneca dhe 7963 me Pfizer, ku ne përqindje me dozën e parë e kanë marr 36.33% kurse me dozën e dytë 17.68% që ne total i bjen që 54% e popullatës janë vaksinuar. Pra, kjo është një informatë e shkurtër rrëth situatës pandemike ne komunën tonë.

Dervish Çadraku – Në lidhje me pikat e reja që u tha me herët ne Ratkoc dhe Krushë të Madhe, a po punohet ne kete drejtim diçka apo do te mbetet prap kështu si është tanë, pasi e pash dje vërtet kishte tollovi kështu pse me ardh ai nga atje kur ka mundësi me marr ne pikën më të afërt në Ratkoc apo në Krushë.

Samir Mustafa – Ne vazhdimisht kemi bërë kërkësë ne Ministrinë e Shëndetësisë mirëpo kërkesa jona nuk ka hasur në mirëkuptim jo vetëm në komunën tonë por në asnjë komunë nuk ka kapacitete logjistike ministria e shëndetësisë me krijuar edhe pika tjera për vaksinim. Arsyetimi është mungesa e stafit dhe mungesa e logjistikes nga ana e ministrisë se shëndetësisë.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor për sqarimet, atëherë meqë nuk kemi tjerë te lajmëruar, konstatoj se kalon për kuvend edhe pika e pestë e rendit te ditës. Kalojmë në pikën e gjashtë te rendit te ditës:

6. Të ndryshme.

Të nderuar kolegë, për mbledhje te kuvendit do ta kemi edhe një pikë shtesë: Informatë rrëth bizneseve në komunën e Rahovecit, ku është diskutuar edhe ne mbledhjen e kaluar nga kolegët tanë. Mendoj që drejtoria e Ekonomisë është duke bërë punën e vet që për mbledhje te kuvendit ta kemi te kompletuar rrëth çështjes se bizneseve. Gjithashtu në këtë pikë dua t'i jap edhe një informatë rrëth bashkëpunimit me OSBE-në me saktësish me përfaqësuesin tonë z. Adem Kollari ku me datën 25.06.2021 kemi pasur një takim të përbashkët me përfaqësues kryesues të kuvendeve komunale dhe zyrtarë të Ministrisë së Pushtetit Lokal, ku fatkeqësish nuk kam mundur me marr pjesë atë mbledhje dhe aty është diskutuar rrëth bashkëpunimit te ekzekutivit dhe legjislativit, pastaj kërkësat e anëtarave te kuvendit sa trajtohen dhe sa merren parasysh dhe disa çështje te rëndësishme që janë diskutuar si me kryesore ne atë takim ka qenë Shqyrimi i ligjshmërisë se akteve komunale ne kuvende dhe e kisha ne takim z. Kollari dhe i kamë dhënë te gjitha informacionet se shqyrimet e ligjshmërive që i marrim me aprovin ne kuvend i dërgojmë me kohë ne MAPL dhe sigurisht që ndonjëherë nuk na kthen ne afatin e caktuar por ne shumicën e herëve na kanë kthye ne afatin kohor që është prej 15 ditëve dhe 7 ditë afat ne gazeten zyrtare, pastaj rolin e kuvendeve komunale ne ushtrimin e mbikëqyrjes se legjislativit. Pra, puna jonë si kuvend për temat që po i ngrisim sikurse sot atëherë drejtoritë apo ekzekutivi sigurisht se po i merr parasysh që i trajton dhe i shqyrton si dhe aktet që janë kthye te kundërligjshme për ndonjë vendim atëherë me afat kohor e kemi trajtue menjëherë si kuvend dhe nuk e kemi asnjë akt si komunë që e kemi kalua afatin ligjor që mos me shkua lënda ne prokurori, pasi që nëse një akt ka qenë i kundërligjshëm sipas MAPL-së atëherë qysh ne mbledhjen e parë e kemi shtie si pikë shtesë edhe e kemi trajtua edhe e kemi përmirësuar apo rekomandimin që kemi marr prej MAPL-së apo e kemi shfuqizua menjëherë vendimin. Kështu që si kuvend jemi shumë mirë në të gjitha vendimet dhe punët e bëra. Gjithashtu e premtova z. Kollari që do t'i informoj anëtarët e Komitetit rrëth kësaj teme. Kjo ishte një informatë e shkurtë që komunikimi mes MAPL-së dhe kuvendeve, që disa komuna kishin pasur ankesa te mëdha për shkak se MAPL-ja nuk është duke ju kthyer aktet me kohë dhe i parapare sipas ligjit ne afatin

prej 15 ditëve, kështu që ajo pjesë tash i takon MAPL-së që te ndërmarrin veprime pasi edhe neve si kuvend nëse nuk kthehen me kohë atëherë atëherë nuk dimë si të veprojmë.

Të nderuar anëtarë të KPF-së, faleminderit të gjithëve për kontributin e dhënë dhe shihemi në mbledhjen e kuvendit që planifikojmë ta mbajmë me datë 16.09.2021.

Procesmbajtësi,

Agim Hoti

KRYESUESI

Afrim Dina

